

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Infermierit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë dhe NJVKSH Gjirokastrë, zhvilluan aktivitetin me temë: "Sfidat e profesionit të infermierit".

Ky aktivitet pati për qëllim t'u përcillte studentëve të rinj rolin, detyrat dhe misionin e infermierit. Studentët patën mundësinë të bisedonin me infermierë mbi sfidat e profesionit dhe përgatitjen etiko-profesionale.

Të pranishëm në aktivitet ishin pedagogë, studentë të degës Infermieri e Përgjithshme, Infermieri Mami, si dhe përfaqësues të NJVKSH-së.

